Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-73
Datë 12.02.2019

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.02.2019 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Validohet dhe akreditohet "Qendra e Kompetencës" në Ferizaj me adresë, rruga "Rexhep Bislimi", për periudhën 01.09.2019 deri 01.09.2022 me kualifikimet:

   1.1. Asistent i fizioterapisë, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP

   1.2. Asistent i kujdesit social dhe shëndetësor, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, raporti i vlerësimit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara, rekomandimeve që bazohen në dëshmi dhe dokumentet e ofruara: Aplikacioni për validim të kualifikimit/modulit; aplikacioni për akreditim si institucionit ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; raporti i vetë-vlerësimit; vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumentet tjera shtesë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

2. Vendimi i dërgohet:

   - Qendra e Kompetencës në Ferizaj
   - AKK



Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema